



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E LARTË**  
**KANCELARI**

Nr. 4133/3 prot

Tiranë, më 13.09.2024

**Lënda:** Njoftim për përfundimin e verifikimit paraprak të kandidatëve pjesëmarrës sipas procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin “specialist i teknologjisë së informacionit (IT), në Drejtorinë e Sigurisë dhe të Teknologjisë së Informacionit”, në Gjykatën e Lartë, kategoria keqzekutive, IV-1.

Në mbështetje të nenit 57 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 29 e në vijim, të kreut IV, të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, si dhe të udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor”, në përfundim të afatit kohor për dorëzimin e dokumentacionit për pranim në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin “*specialist IT, në Drejtorinë e Sigurisë dhe të Teknologjisë së Informacionit*”, kategoria e pagës IV-1, ju bëjmë me dije se kandidati i kualifikuar, që plotëson kërkesat e përgjithshme e të veçanta sipas shpalljes së publikuar për të marrë pjesë në testimin me shkrim është:

**1. Z. Glendi Hyka.**

Testimi me shkrim për pozicionin do të zhvillohet më datë **18.09.2024, ora 12:00**, në ambientet e Gjykatës së Lartë, në rrugën “Ibrahim Rugova”, Tiranë. Pyetjet me shkrim do të mbështeten në fushën e njohurive të publikuar brenda shpalljes.

Duke ju falenderuar ,

**KANCELARI NË DETYRË**

**ANILA KULO**